

AKT THEMELIMI

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"CONDOR" SH.P.K.

Sot, më datë 11. 06. 2004, Ne të nënshkruant :

1. **Z. Arjan LESKAJ**, i biri i Astirit dhe i Valentinës, i datëlindjes 11. 04. 1968, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën : Bul. "Gjergj Fishta", Pall. 5, Ap. 64, Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. 0004447.
2. **Z. Artan DULAKU**, i biri i Nikos dhe i Lirikës, lindur më 30. 05. 1965, në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar mbajtës i pasaportës me nr. Z 0031648.
3. **Z. Anthim VJERO**, i biri i Pipos dhe i Antiginit, lindur më 06. 11. 1954, në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën : Rruga "Sulejman Pasha". Pall. 70/1 Ap. 5, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr. 0823317.
4. **Z. Bashkim KARAMUÇA**, i biri i Ramizit dhe i Lajës, lindur më 24. 06. 1969, në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën, Vorë, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z0084003
5. **Z. Gjergji HOXHA**, shtetas shqiptar, lindur më 05. 10. 1965, ne Korçë, Shqiperi, banues në adresën : Rruga "Asim Vokshi" Pall. 49/1 Ap. 5, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z.0189297.

në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 14.12.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" kemi vendosur të themelojmë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "CONDOR" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është "CONDOR" Sh.p.k.

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Konferenca e Pezës", Ish-Parku i Autobuzave, Tiranë. Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale në të gjithë vendin.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e pakufizuar mbi 10 (dhjetë) vjet, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 4

Objekti i Shoqërisë është si vijon:

- Prodhimi dhe tregëtimi me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit, import eksport i tyre brenda dhe jashtë

vendit për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tretëve, ku përfshihen inerte, gurë, gurë dekorative, gëlqere, pllaka parafabrike, llac, çimento, hekur rerë dhe çdo material tjetër për ndërtim.

- Projektimi dhe zbatimi i veprave ndërtimore si vijon : ndërtime me karakter civil dhe ekonomik, punime/gërmime dhe sistemime dheu, terracime terrenesh, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndërtime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndërtime rrugësh, asfaltime, hapje kanalesh si dhe çdo ndërtim tjetër me karakter civil dhe ekonomik.
- Zhytërimi dhe ndërmjetësimi i projekteve për rikonstruksionin e ndërmarrjeve industriale. Sigurimi i projekteve industriale ashtu si dhe strukturimi i kontratave afatgjata për lëvrime dhe mbi bazën e këtij rifinancimi dhe kreditimi. Ndërmjetësimi nxjerrja dhe përpunimi i lëndëve të para të të gjitha llojeve, veprimtari shërbime, etj.
- Kontraktimi me persona fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes për prodhimet e shoqërisë.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë dhe është i ndarë në 100 kuota me të njëjtën madhësi, vlera nominale e të cilave është 1000 Lekë. Kontributi i çdo ortakut në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë :

- Z. Arjan LESKAJ, zotëron 20% (njëzet përqind) të kapitalit ose 20 kuota me vlerë prej 1000 Lekë.
- Z. Artan DULAKU, zotëron 20% (njëzet përqind) të kapitalit ose 20 kuota me vlerë prej 1000 Lekë.
- Z. Anthim VJERO, zotëron 10% (dhjetë përqind) të kapitalit ose 10 kuota me vlerë prej 1000 Lekë.
- Z. Bashkim KARAMUÇA, zotëron 26.6% (njëzet e gjashtë pik gjashtë përqind) të kapitalit ose 26.6 kuota me vlerë prej 1000 Lekë.
- Z. Gjergji HOXHA, zotëron 23.4% (njëzet e tre pik katër përqind) të kapitalit ose 23.4 kuota me vlerë prej 1000 Lekë.

Derdhja e kapitalit themeltar është bërë në mënyrën e mëposhtme :

- Ortakët kanë derdhur në para shumën prej 100.000 leke, me anë të depozitimit të saj në llogari bankare.

Ortakët mund të vendosin për ritjen e kapitalit në perputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

Detyrimet e çdo ortakut kundrejt shoqërisë përballohen vetëm për pjesën e kapitalit të derdhur nga ai. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortakut nuk mban përgjegjësi.

Neni 6

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga vetë ortakët e shoqërisë dhe organet e saj të cilat janë si më poshtë :

1. Asambleja e Ortakëve
2. Administratori

- Administratorë të shoqërisë do të jenë :

- Z. Shefki KARAMUÇA, shtetas shqiptar, lindur më 17. 01. 1968, në Tiranë, Shqipëri, banues në Vorë, Tiranë, mbajtës i pasaportës me Nr. Z. 0783004, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

- Z. Gjergji HOXHA, shtetas shqiptar, lindur më 05. 10. 1965, në Korçë, Shqipëri, banues në adresën : Rruga " Asim Vokshi" Pall. 49/1 Ap. 5, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr.Z.0189297.

Mënyra dhe Administrimi i shoqërisë është i përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Neni 7

Ortakët e shoqërisë dhe administratorët ligjor të saj janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

Neni 8

Në se shoqëria do të likuidohet atëherë do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtrojë një bilanc likuidimi për miratim.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet ortakëve në lidhje me këtë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhet me mirëkuptim dhe do të diskutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.


Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje me mirëkuptim të mosmarrëveshjes, çështja do t'i kalojë për gjykim Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Neni 10


Akti i Themelimit është hartuar në 6 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT


Z. Arjan LESKAJ




Z. Anthim VJERO




Z. Gjergji HOXHA



Z. Artan DULAKU



Z. Bashkim KARAMUÇA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 1689 Rep.
Nr. 230 Kol.



VËRTETIM


Sot më datë 11. 06. 2004, para meje Shpres KURTI Notere Publike pranë Dhomës së Noterëve Tiranë u paraqitën personat:

1. Z. Arjan LESKAJ, i biri i Astirit dhe i Valentines, i datëlindjes 11. 04. 1968, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: Bul. "Gjergj Fishta", Pall. 5, Ap. 64, Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. 0004447
2. Z. Arjan DULAKU, i biri i Nikos dhe i Lirikes, lindur më 30. 05. 1965, në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z 0031648.
3. Z. Anthim VJERO, i biri i Pipos dhe i Antigonit, lindur më 06. 11. 1954, në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: Rruga "Sulejman Pasha". Pall. 70/1 Ap. 5, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr. 0823317.
4. Z. Bashkim KARAMUCA, i biri i Ramizit dhe i Lajës, lindur më 17. 01. 1968, në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën, Vorë, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z. 0084003.
5. Z. Gjergji HOXHA, shtetas shqiptar, lindur më 05. 10. 1965, në Korçë, Shqiperi, banues në adresën: Rruga "Asim Vokshi" Pall. 49/1 Ap. 5, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z.0189297.

të cilët më deklaruan se dokumenti i bashkëngjitur këtij Vërtetimi është Akti i Themelimit të Shoqërisë "CONDOR" Shpk, i hartuar dhe i nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, dhe unë, noterja i vërtetoj nënshkrimin e tyre regullisht sipas ligjit.

NOTERE

Shpresa KURTI



STATUTI I SHOQËRISË

"CONDOR" SHPK



Në bazë të ligjit 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", dhe ligjit 7667 datë 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregtar", ne të nënshkruarit shpallim si më poshtë vijon:

FORMIMI I SHOQËRISË

Neni 1

Formohet shoqëria e quajtur "CONDOR" SHPK me ortakë :

1. **Z. Arjan LESKAJ**, i biri i Astirit dhe i Valentinës, i datëlindjes 11. 04. 1968, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën : Bul. "Gjergj Fishta", Pall. 5, Ap. 64, Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z004447.
2. **Z. Artan DULAKU**, i biri i Nikos dhe i Lirikës, lindur më 30. 05. 1965, në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z 0031648.
3. **Z. Anthim VJERO**, i biri i Pipos dhe i Antigoni, lindur më 06. 11. 1954, në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën : Rruga "Sulejman Pasha". Pall. 70/1 Ap. 5, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr. 0823317.
4. **Z. Bashkim KARAMUÇA**, i biri i Ramizit dhe i Lajës, lindur më 17. 01. 1968, në Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën, Vorë, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0084003.
5. **Z. Gjergji HOXHA**, shtetas shqiptar, lindur më 05. 10. 1965, ne Korçë, Shqiperi, banues në adresën : Rruga "Asim Vokshi" Pall. 49/1 Ap. 5, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z.0189297.

QENDRA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën, Rruga "Konferenca e Pezës", Ish-parku i Autobuzave, Tiranë. Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale në të gjithë vendin.

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar mbi 10 (dhjetë) vjet dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

- Prodhimi dhe tregëtimi me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit, import eksport i tyre brenda dhe jashtë

vendit për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tretëve, ku përfshihen inerte, gurë, gurë dekorative, gëlqere, pllaka parafabrikate, llac, çimento, hekur rerë dhe çdo material tjetër për ndërtim.

Projektimi dhe zbatimi i veprave ndërtimore si vijon : ndërtime me karakter civil dhe ekonomik, punime/gërmime dhe sistemime dheu, terracime terrenesh, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndërtime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndërtime rrugësh, asfaltime, hapje kanalesh si dhe çdo ndërtim tjetër me karakter civil dhe ekonomik.

Zhvillimi dhe ndërmjetësimi i projekteve për rikonstruksionin e ndërmarrjeve industriale. Sigurimi i projekteve industriale ashtu si dhe strukturimi i kontratave afatgjata për lëvrime dhe mbi bazën e këtij rifinancimi dhe kreditimi.

Ndërmjetësimi nxjerrja dhe përpunimi i lëndëve të para të të gjitha llojeve, veprimtari shërbime, etj.

Kontraktimi me persona fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes për prodhimet e shoqërisë.

Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të risë kapitalin sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë dhe është i ndarë në 100 kuota të te njejtës madhësi me vlerë nominale 1.000 lekë cdo kuote. Cdo ortak ka të drejtën e votës në përputhje me numrin e kuotave që ai zoteron në këtë shoqëri.

Kontributi i ortakëve në kapitalin themeltar është si më poshtë:

- Z. Arjan LESKAJ, zotëron 20% (njëzet përqind) të kapitalit ose 20 kuota me vlerë prej 1000 Lekë.
- Z. Artan DULAKU, zotëron 20% (njëzet përqind) të kapitalit ose 20 kuota me vlerë prej 1000 Lekë.
- Z. Anthim VJERO, zotëron 10% (dhjetë përqind) të kapitalit ose 10 kuota me vlerë prej 1000 Lekë.
- Z. Bashkim KARAMUCA, zotëron 26.6% (njëzet e gjashtë pik gjashtë përqind) të kapitalit ose 26.6 kuota me vlerë prej 1000 Lekë.
- Z. Gjergji HOXHA, zotëron 23.4% (njëzet e tre pik katër përqind) të kapitalit ose 23.4 kuota me vlerë prej 1000 Lekë.

Neni 7

Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të të gjithë ortakëve.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjisllacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Regjistrin Tregtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe pasi të marrë licensën përkatëse nga organi përkatës tatimor.

Neni 9

Ortakët e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur prej tyre nuk mund ta tërheqin. Kjo mund

të bëhet vetëm pasi të nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.

Neni 10

Pjesët shoqërore të çdo anëtari përputhen me pjesën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Çdo anëtar mund të ketë një pjesë shoqërore, nëqoftëse anëtari siguron pjesë të tjera shoqërore atëherë pjesa e tij rritet në përputhje me këtë. Pjesët e tij anëtari i shoqërisë mund t'ua ofrojë të tretëve. Anëtarët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e pjesës shoqërore përpara personave të tretë jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar cmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Organi administrativ jep përgjigje brenda 30 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet të japin një përgjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e përparësisë duhet të ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e përparësisë është në proporcion me kuotat e secilit prej ortakëve. Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë keto kuota brenda 90 ditëve i ofrohen personave të tretë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet të bëhen me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Ortakëve.

Po kështu transferimi i kuotave në rugë trashëgimie bëhet sipas neneve 46, 47, 49 të ligjit 7638 dt 19.11.1992. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve. Kuotat prej 1.000 Lekë janë të pandashme. Në rastet e bashkëpronësise veprohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratorëve, si dhe emrat e Ortakëve duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Neni 12

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore. Ortakët e shoqërisë drejtojnë procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të tretëve pa asnjë kufizim.

Organet e shoqërisë janë :

- 1- Asambleja e Ortakëve
- 2- Administratorët

ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Neni 13

Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e cila mbledhet nga çdo anëtar i shoqërisë që përfaqëson të paktën 40% të kapitalit të shoqërisë. Antarët duhet të njoftohen 15 ditë përpara dhe në lajmërim duhet të jetë shkruar vendi, ora dhe problemet që do të trajtohen.

Nëqoftëse Asambleja është mbledhur sipas rregullave të caktuara ajo mund të marrë vendim kur çdo anëtar i shoqërisë është prezent dhe nuk kundërshton mbledhjen e Asamblesë. Çdo anëtar i shoqërisë ka të drejtë të verë në rendin e ditës problemin që ai dëshiron. Për këtë duhet të informohen anëtarët 3 ditë përpara. Vendimet duhet të merren në rastin konkret kur janë prezent të Pestë ortakët dhe kur nuk bien dakort duhet të pyetet një person i tretë i cili është specialist për problemin që është në diskutim dhe do të vendoset duke marrë në konsideratë dhe mendimin e specialistit.

TE DREJTAT E ASAMBLESE

Neni 14

Asambleja e ortakëve ka kompetencat e mëposhtme :

- Ka të drejtë të bëjë ndryshime në statut në rast kur janë dakord ortakët që përfaqësojnë tre të katërtat e kapitalit themeltar.
 - Ka të drejtë të miratojë bilancin e shoqërisë dhe të bëjë ndarjen e fitimit.
 - Ajo emëron administratorët, zëvendësin, ekspertët dhe revizorët kontabël.
 - Ajo ka të drejtë të bëjë përjashtimin e një ortaku nga shoqëria për rastet e parashikuara në ligj si dhe në rregulloren e brendshme të shoqërisë.
- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencë të Asamblesë.
- Percakton shpërbimin për administratorët, ekspertët, revizorët kontabël.
- Bën transferimin e kuotave të tretët.
- Bën lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender, ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të luajtshme dhe të pasurive të paluajtshme të shoqërisë etj.
- Ka të drejtë të bëjë modifikimin e kontratës së shoqërisë.

Neni 15

Asambleja është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme. Asambleja mbledhet të paktën 1 herë në vit, brenda 4 muajve nga dita e mbylljes së veprimtarisë. Në kushte të veçanta Asambleja e zakonshme mund të mbledhet dhe brenda 6 muajve nga dita e mbylljes së veprimtarisë së shoqërisë.

Asambleja e jashtëzakonshme thirret me vendimin e saj kur Organi Administrativ e sheh të arsyeshme ose kur kërkohet nga ortakët që përfaqësojnë 10% të kapitalit të shoqërisë. Në këtë rast Organi Administrativ ka të drejtë të vendosë ditën e mbledhjes jo më larg se 30 ditë nga dita e kërkesës.

Neni 16

Kur pjesëmarrja në asamble është normale vendimet që merren brenda kufijve të kontratës së themelimit, Statutit e të ligjeve janë të detyrueshme për të gjithë, edhe për ata që nuk kanë diskutuar edhe për ata që nuk janë dakord.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër që nuk është administrator. Asnjë i dërguar nuk mund të përfaqësojë më shumë se një ortak.

Në Asamblenë e Ortakëve marrin pjesë nëse është e nevojshme për të dhënë mendim dhe me të drejtë vote ekspertë, revizorë etj.

Çdo vendim që do të merret duhet të merret në mënyrë kolegjiale.

Shoqëria do të ketë si parim të saj gjatë gjithë veprimtarisë së saj kolegjalitetin gjë që do të thotë se për çdo lloj veprimi në shoqëri e për më tepër për veprime financiare duhet të merret patjetër vendim kolegjial, askush nga ortakët nuk ka të drejtë të veprojë në mënyrë individuale dhe është e domosdoshme firma e të gjithë ortakëve.

Kjo bëhet për të siguruar ekzistencën e shoqërisë, për të ruajtur vlerat dhe pasuritë e saj.

Neni 17

Asambleja thirret në rastet e parashikuara më poshtë :

a) Në thirrjen e parë në praninë e ortakëve që janë vetë prezent ose të përfaqësuar nga persona të tret me prokurë të posaçme dhe që zotërojnë 100% të kapitalit themeltar. Në këtë rast do të diskutohet në lidhje me problemet më të

rëndësishme të shoqërisë të cilat kërkojnë si të domosdoshme praninë e katër ortakëve.

b) Në thirrjen e dytë në prezencë të ortakëve që janë vetë prezent ose të përfaqësuar nga persona të tretë me prokurë të posaçme dhe që zotërojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar.

Nëse në thirrjen e parë asambleja nuk mbledhet, herën e dytë ajo mund të vendosë vetëm mbi problemet që janë në rendin e ditës përsëri me prezencën e ortakëve ku njëra firmë të jetë ajo e Kryetarit të Asamblesë. Në të dyja rastet si kur mbledhet Asambleja e Zakonshme dhe kur mbledhet ajo e Jashtëzakonshme në rast se Kryetari i Asamblesë ose i përfaqësuari i tij nuk është prezent mbledhja shtyhet për një datë tjetër në mënyrë që t'i jepet mundësia Kryetarit të Asamblesë ose përfaqësuesit të tij të marrin pjesë në mbledhje. Në qoftëse njëri nga ortakët ka prokurë nga Kryetari i Asamblesë ai mund të veprojë në emër të tij pa qenë e nevojshme shtyrja e mbledhjes.

Neni 18

Marrëveshjet e Asamblesë, mbajtja e proces verbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

ADMINISTRIMI

Neni 19

Shoqëria administrohet nga dy Administratorë të cilët caktohen në statutin e shoqërisë dhe me pas nga Asambleja e Ortakëve. Administratorët qëndrojnë në detyrë për një periudhë të pakufizuar kohore dhe në rast së gjatë kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e tyre, Asambleja e Ortakëve vendos shkarkimin e tyre duke treguar me fakte dëmin që i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tyre pasi është dhënë mendimi për këtë dem edhe nga specialistët përkatës.

Asambleja mund të vendosë lejin e një shpërblimi në favor të Administratorëve për kryerjen e detyrës përveç pagimit të shpenzimeve.

Aktualisht Administratorë të shoqërisë do të jenë :

- Z. Shefki KARAMUÇA, shtetas shqiptar, lindur më 17. 01. 1968, në Tiranë, Shqipëri, banues në Vorë, Tiranë, mbajtës i pasaportës me Nr. Z. 0783004, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
- Z. Gjergji HOXHA, shtetas shqiptar, lindur më 05. 10. 1965, në Korçë, Shqipëri, banues në adresën : Rruga " Asim Vokshi" Pall. 49/1 Ap. 5, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr.Z.0189297.

Neni 20

Administratori mund të emrojë një ose me shume administratorë të deleguar ose përfaqësues të thjeshtë për të kryer veprime të veçanta duke përcaktuar fuqinë e tyre brenda kufijve e duke e respektuar statutin dhe ligjet në fuqi dhe vendos dhënien e një shpërblimi në favor. Detyrat e tyre do të përcaktohen në një rregullore të brendshme të shoqërisë.

Neni 21

Administratori ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejnë të gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marrëveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe në Statut që i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Neni 22

Administratorët kanë të drejtë të nënshkruajnë për kapitalin e shoqërisë, kontrata të ndryshme, për furnizime publike private, çdo lloj operacioni bankar deri në 100.000 USD (një qind mijë dollarë amerikanë) dhe mbi këtë shumë vendos

Asambleja e Ortakëve, të veprojnë me çdo lloj instituti bankar publik e privat, të ndërmarë veprime gjyqësore, transaksione të ndryshme, etj, si dhe ka të gjitha të drejtat që janë parashikuar në ligj sipas nenit 50 të tij. Administratori mund të japë prokura në kufijtë që i lejon Asambleja e Ortakëve për kategori të caktuara veprimesh.

Administratorët janë të detyruar të mbajnë regjistrat e magazinimit të cilat vihen në dispozicion të organeve kompetente shtetërore për të mundësuar kryerjen e kontroleve prej saj. Administratorët e shoqërisë janë të detyruar të mbajnë inventare të rregullta një herë në muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore, hartohen nga Administratori.

PJESMARRJA NË VENDIME **Neni 23**

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime si dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zoteron. Një ortak mund të përfaqësohet nga një ortak ose nga një person tjetër me prokurë të posaçme.
Një ortak nuk mund të ngarkojë një mandatarbajtës të votojë në emër të një pjesë të kapitalit të tij themeltar duke votuar ai vetë e emër të pjesës së tjetër të kapitalit të tij themeltar.

MARRËDHËNIET E PUNËS **Neni 24**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktajnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETit **Neni 25**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratorët e kësaj shoqërie.

EKSPERTËT OSE REVIZORËT KONTABËL **Neni 26**

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorëve, veprimtarinë e tyre si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të veçanta ligjore.

BILANCI DHE FITIMET **Neni 27**

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të mbyllet në datën 31 Dhjetor të çdo viti. Administratorët marrin masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si më sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten ndahen midis ortakëve dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.

Neni 28

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të realizuara rezulton më pak se kapitali themeltar, pronarët vendosin brënda 4 muajve mundësinë e prishjes së jashtëzakonshme të shoqërisë.

Mënyra dhe Administrimi i shoqërisë është i përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Neni 7

Ortakët e shoqërisë dhe administratorët ligjor të saj janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

Neni 8

Në se shoqëria do të likuidohet atëherë do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtrojë një bilanc likuidimi për miratim.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet ortakëve në lidhje me këtë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhet me mirëkuptim dhe do të diskutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje me mirëkuptim të mosmarrëveshjes, çështja do t'i kalojë për gjykim Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Neni 10

Akti i Themelimit është hartuar në 6 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

Z. Arjan LESKAJ

Arjan Leskaj

Z. Anthim VJERO

Anthim Vjero

Z. Gjergji HOXHA

Gjergji Hoxha

Z. Artan DULAKU

Artan Dulaku

Z. Bashkim KARAMUÇA

Bashkim Karamuca